



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	02 - 11 2020	0	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHHK	2394/2020		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.259/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.259/2020 të datës 04.09.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë rruga “Gjon Buzuku”, Nr.31 në Skenderaj, kundër Vendimit me Nr.Ref:626/2020 të datës 28.08.2020 të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë shqyrtimin e ankesës me numër protokollit 1025 të datës 19.06.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], si dhe të gjitha pretendimet tjera të mëvonshme të cilat ndërlidhen më këtë lëndë, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.**
- II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.**
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.**

A r s y e t i m

Ankuesit ██████████, sipas Vendimit me numër 125/2020 të datës 30.03.2020 të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i është përfunduar mandati me datë 30.06.2020, si i emëruar Sekretar i Parë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Riad, Arabi Saudite.

Me datë 13.05.2020 Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me Vendimin Nr.198/2020 ka shtyrë ekzekutimin e vendimeve që i referohen tërheqjes së diplomatëve nga misionet diplomatike apo postet konsullore, duke u përfshirë dhe Vendimin Nr. Ref. 125/2020 të datës 30.03.2020.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin Nr. 125/2020 të datës 30.03.2020 dhe vendimin Nr.198/2020 të datës 13.05.2020, ka parashtruar me datë 19.06.2020 ankesë Nr. protokolli 1025 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendime ankimore se vendimet e Ministrit të MPJD janë të pa drejta.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 17.07.2020, ka njoftuar ankuesin se nuk ka mandat ligjor për shqyrtimin e ankesës së tij, sepse ky Komision shqyrton vetëm ankesat e shërbyesve civilë të MPJD-së.

Me datë 28.08.2020 Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës me vendim Nr. Ref.629 /2020 të datës të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shfuqizimin e pezullimit të vendimit nr.ref:125/2020 të datës 30.03.2020.

Ankuesi ka parashtruar ankesë më datë 04.09.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. Protokolli 1696/20, duke atakuar vendimin numër 125/2020 të datës 30.03.2020 si të pa drejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Me datë 23.09.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit, me kërkesë të Kryetares së Kolegjit, më datë 16.10.2020 ka nxjerr Vendimin VK.nr.2/2020 përmes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën Nr.259/2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën Anr.259/2020 me numër protokolli 1696/2020 të datës 04.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.ref.629/2020 i datës 28.08.2020; Vendimi nr.ref.125/2020 i datës 30.03.2020; Vendimi Nr.198/2020; Vendimi i vitit 2012; Vendimii datës 22.03.2016 nr. ref. 104/2016; Dëshmi e dokumenteve të dorëzuara e datës 19.08.2011; Email i datës 28.01.2012; Email i datës 01.02.2012; Kërkesë drejtuar Zyrës së Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Përgjigje ne ankese e datës 28.09.2020; Njoftim i datës 17.07.2020 nga Komisioni për zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e datës 19.06.2020; Email i datës 03.02.2012; Kërkesën për shtyrje të afatit e datës 16.10.2020; Vendimin me VK.nr.2/2020 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka mandat ligjor për trajtimin e ankesës me numër protokolli 1025 të datës 19.06.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se vendimi Nr. 125/2020 i datës 30.03.2020, vendimi Nr.198/2020 i datës 13.05.2020 dhe vendimi Nr. Ref. 629/2020 i datës 28.08.2020 të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk përmbajnë këshillë juridike, po ashtu njoftimi i Kryesuesit të KZKA-së i datës 17.07.2020 nuk e përmban udhëzime mbi afatin brenda të cilës pala mund të ankohet në organin kompetent, andaj Kolegji vlerëson se ankesat e ankuesit Nr. protokolli 1025 e datë 19.06.2020 dhe A.nr.259/2020 e datës 04.09.2020 e parashtruar pas njoftimit të KZKA-së të datës 17.07.2020, janë në pajtim me nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, vlerëson së procedurat disiplinore dhe procedurat e ankesave dhe kontesteve të cilat kanë filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojnë sipas dispozitave të atij ligji, përveç nëse vlerësohet nga pala së është më e favorshme procedura e ligjit të ri, por aplikimi i ligjit të ri mund të bëhet vetëm me kërkesë të palës.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se kjo procedurë ka filluar sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, e duke u bazuar në nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, nenit 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, si dhe nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mori vendim që lënda ti kthehet për vendosje Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimet e Jashtëm, pranimi në shërbim të jashtëm behët përmjet konkursit të hapur si dhe pajtim me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik si dhe legjislacionit në fuqi. Ndërlidhur me këtë Neni 8 i Ligjit 03/L-044 Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik ka përcaktuar *“ Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës*. Bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, shqyrtimin e kësaj lënde duhet ta bëjë konform legjislacionit të aplikueshëm për Shërbimin Civil, dhe rregullave të veçanta të Shërbimit të Jashtëm.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.259/2020

Zyle Millaku Gojnovci

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj - Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

